



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin qershor 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit qershor 2019 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Në këtë muaj janë ndjekur me prioritet të veçantë disa problematika të shfaqura nga sipërmarrjet, veçanërisht përsa i përket sigurisë së produkteve ushqimore, dokumentacionit të kërkuar nga ana e agjensive monitoruese në vendin tonë si dhe transparencës që shoqëron proceset verifikuese në raste të ndryshme.

Gjatë pjesëmarrjes në aktivitetin e organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë "Forumi i grave sipërmarrëse" u theksua rëndësia e jashtëzakonshme e mbështetjes së grave sipërmarrëse nga ana e të gjitha institucioneve dhe agjensive ligjzbatuese, duke e konsideruar këtë proces si një motor zhvillues për ekonominë shqiptare.

Në kuadër të rritjes ekonomike në vendet e Rajonit të Ballkanit Perëndimor, në forumin e organizuar nga Financial Times u diskutua në lidhje me krijimin e mundësive dhe thjeshtëzimin e procedurave të sipërmarrjes me qëllim zgjerimin e investimeve direkte të huaja me baza rajonale. Gjithashtu ju kushtua një rëndësi e veçantë faktorëve të cilët e bëjnë këtë rajon konkurrues duke përfshirë ndër të tjera vendndodhjen strategjike dhe lidhjet e drejtëpërdrejta me tregun europian, koston e lirë të krahut të punës si dhe tendencat në rritje për krijimin e qendrave të inovacionit.

Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,

Eduard Shalsi



Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr. 1	MM	11.07.2018	Subjekti kërkon kryerjen e pagesës për shërbimet e kryera në fushën e Emergjencave Civile.	Në proces
Nr. 2	MB	06.12.2018	Subjekti ankohet në lidhje me Urdhrin e përbashket "Për ndalimin e hedhjes në treg të fishekzjarreve"	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 3	Bashkia	12.01.2019	Subjekti kërkon adresim ose sugjerim të procedurave që duhet të ndiqen përpara i përket transportit urban dhe marrdhënieve me Bashkinë.	Në proces
Nr. 4	MTM	01.02.2019	Subjekti kërkon asistencë për pajisjen me lejen mjedisore dhe përgjigje ndaj kërkesës online.	Në proces
Nr. 5	Kryeministria	22.02.2019	Subjekti kërkon përgjigje mbi procedurën e prokurimit me objekt "Prishje të ish Frigoriferit në Vlorë", ankuesi shpreh se KPP nuk pranon ankesën e tyre.	Në proces
Nr. 6	MFE	05.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me zgjedhjet në Dhomën e Tregtise	Në proces
Nr. 7	MBZHR	17.02.2019	Kërkesë për interpelancë	Në proces
Nr. 8	MZHBR	19.02.2019	Subjekti kërkon mbrojtjen e të drejtës së ekskluzivitetit si dhe mosçenimin e sigurisë ushqimore.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 9	MIE	22.02.2019	Subjekti ankohet për pjesëmarrje në procedurën konkurruese leje kërkim-zbulimi.	Në proces
Nr. 10	Bashkia	25.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mosshlyerjen e detyrimeve për projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale.	Në proces
Nr. 11	MFE	01.03.2019	Subjekti pretendon se ka pasur veprime arbitrare nga dogana në lidhje me rivlerësimin e deklarave doganore.	Në proces
Nr. 12	MFE	06.03.2019	Subjekti ankohet për penalitet të lartë nga administrata tatimore.	Në proces
Nr. 13	Kryeministria	10.03.2019	Subjekti kërkon legalizimin e objektit ku ushtron aktivitetin bar-kafe.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 14	MIE	14.03.2019	Subjekti kërkon përmirësim të rrugës për të aksesuar biznesin.	Në proces
Nr. 15	MFE	15.03.2019	Subjekti ankohet për kushte diskriminuese për lejimin e	Në proces

			ushtrimit të profesionit arkitekt dhe inxhinier.	
Nr. 16	MFE	21.03.2019	Subjekti kërkon përfshirjen e fidanëve të shafranit në listën e inpleteve bujqësore të përjashtuara nga TVSH-ja.	Në proces
Nr. 17	MFE	28.03.2019	Subjekti denoncon konkurrencen e pandershme që zhvillohet nga bizneset online të regjistruara në QKB që operojnë përmes Instagram & Facebook.	Në proces
Nr. 18	Bashkia	29.03.2019	Subjekti kërkon asistencë për zbardhjen e Lejes së Ndërtimit të aprovuar në 2007 nga Bashkia e rrethit Elbasan.	Në proces
Nr. 19	MIE	29.03.2019	Subjekti ankohet në lidhje me faturim të pasaktë të energjisë elektrike.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 20	MTM	02.04.2019	Ankese për moszbatim të vkm nr. 115, dt 6.03.2012 dhe VKM nr. 232, dt 26.04.2012	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 21	Kryeministria	06.04.2019	Subjekti kërkon asistencë në lidhje me një leje ndërtimi.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 22	MFE	08.04.2019	Subjekti kërkon vërtetimin e veprimtarisë së një shoqërie që kryen konkurrencë të padrejtë në treg.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 23	MFE	10.04.2019	Subjekti ankohet për detyrimet tatimore si dhe ndaj Bashkisë.	Në proces
Nr. 24	MIE	11.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me procedurat e miratimit të një impianti fotovoltai.	Në proces
Nr. 25	MiSHMS	15.04.2019	Subjekti kërkon të zhvillojë një takim me Zv/kryeministrin.	Në proces
Nr. 26	MTM	15.04.2019	Subjekti kërkon miratimin e procedurës dhe përditesimet përkatëse në kadastrën e pyjeve.	Në proces
Nr. 27	Bashkia	15.04.2019	Subjekti kërkon mbështetje për ngritjen e qendrës së zhytjes në Vlorë.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 28	Bashkia	16.04.2019	Subjekti kërkon asistencë për shlyerjen e detyrimeve për procedurën e prokurimit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 29	MIE	17.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me ndërprerjet e energjisë që ndikojnë funksionalitetin e fabrikes.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 30	Bashkia	18.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me mos likuidimin e faturave dhe dëmin ekonomik të shkaktuar nga	Në proces

			Bashkia Klos per objekte tenderimi te perfunduara.	
Nr. 31	MIE	23.04.2019	Subjekti ankohet për mos-kthim përgjigje nga ana MIE.	Në proces
Nr. 32	MIE	22.04.2019	Subjekti ankohet ne lidhje me një problematike nga OSHEE për shtim fuqie të energjise elektrike.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 33	Bashkia	23.04.2019	Subjekti kërkon verifikim dhe ndryshim të taksave vendore t të pasakta të vendosura në lidhje me një pronë.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 34	MFE	26.04.2019	Subjekti kërkon asistencë për përfitimin e një granti për realizimin e biznesit të tij.	Në proces
Nr. 35	MFE	26.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me një kontroll tatimor ndaj subjektit të cregjistruar.	Në proces
Nr. 36	MD	27.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me pamundesinë e legalizimit të një kapanoni në Durres.	Në proces
Nr. 37	Bashkia	30.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me moslargimin e një barake të shkatërruar nga bashkia.	Në proces
Nr. 38	Bashkia	30.04.2019	Subjekti ankohet në lidhje me nje gjobë vendosur kundrejt një NIPT-i pasiv, administratori i të cilit ka vdekur.	Në proces
Nr. 39	Bashkia	02.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për zhbllokimin e rruges për te aktiviteti i biznesit te tij.	Në proces
Nr. 40	MIE	01.05.2019	Subjekti kërkon pajisjen me leje të përdorimit të ujit për HEC-e ekzistuese e të ndërtuara nga shteti shqiptar por që i janë dhënë shoqërise koncesionare.	Në proces
Nr. 41	MFE	08.05.2019	Subjekti kërkon informacion në lidhje me rimbursimin e akcizës drejt Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane, për të cilën nuk ka marrë përgjigje.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 42	Kryeministria	08.05.2019	Subjekti kërkon lejimin e ushtrimit të aktivitetit të ndërtimit të jahteve në zonat e konsideruara "brigje".	Në proces
Nr. 43	MTM	13.05.2019	Subjekti ankohet për pezullim aktiviteti.	Në proces
Nr. 44	AMF	14.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me falimentimin e shoqerisë dhe problematikat e shkaktuara te grupi respektiv.	Në proces
Nr. 45	MBZHR	14.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me ashpërsimin e denimeve per sigurine ushqimore, kur nuk krijohen kushte te përshtatshme nga qeveria për përmirësimin e sigurisë ushqimore.	Në proces

Nr. 46	MB	17.05.2019	Subjekti kërkon lëshimin e licencave të eksportit dhe interpretimin juridik të urdhrit 661.	Në proces
Nr. 47	MBZHR	17.05.2019	Subjekti kërkon përgjigje në lidhje me aplikimin e kontrollit për jetëgjatësinë nga ana e AKU.	Në proces
Nr. 48	MFE	21.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me situatën pothuajse monopol në treg në lidhje me shoqëritë inspektuese të ashensoreve.	Në proces
Nr. 49	Bashkia	22.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me moslëshimin e një leje ndërtimi.	Në proces
Nr. 50	MZHBR	22.05.2019	Subjekti kërkon përgjigje nga AKU në lidhje me gjokat dhe bllokimin e mallit nga ana e AKU.	Në proces
Nr. 51	MFE	22.05.2019	Subjekti kërkon zhbllokimin e llogarive personale që i janë bllokuar si pasojë e pozicionit si administrator në një biznes.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 52	MFE	24.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për adresimin e faturave për zhvillimin e sistemit të të dhënave akomoduese turistike.	Në proces
Nr. 53	MIE	24.05.2019	Subjekti kërkon një interpretim në lidhje me zbatimin e nenit 22 të Ligjit nr. 7/2017 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme'.	Në proces
Nr. 54	MIE	24.05.2019	Subjekti kërkon pajisjen me leje të përdorimit të ujit për HEC-e ekzistuese e të ndërtuara nga shteti shqiptar por që janë dhënë shoqërisë koncesionare.	Në proces
Nr. 55	MD	27.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për rihapjen e aktivitetit.	Në proces
Nr. 56	MFE	29.05.2019	Subjekti kërkon asistencë për mbylljen e aktivitetit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 57	MBZHR	30.05.2019	Subjekti ankohet në lidhje me moslëshimin e një leje ndërtimi për veprimtari ekonomike në fushën e agrobiznesit.	Në proces
Nr. 58	MSHMS	31.05.2019	Subjekti kërkon rishikim të procedurave për publikimin e librave shkollorë.	Në proces
Nr. 59	MIE	31.05.2019	Subjekti kërkon informacion mbi zbatimin e detyrimeve kontraktuale të kontratës koncensionare të HEC-Malind 2,3.	Në proces
Nr. 60	MFE	31.05.2019	Subjekti ankohet për bllokim të llogarive bankare nga tatimet.	Në proces

Nr. 61	Bashkia	05.06.2019	Subjekti ankohet për procedurat në tendera, mungesë konkurrence.	Trajtuar me përgjigje
Nr. 62	MFE	10.06.2019	Subjekti kërkon takim me Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si dhe specialistëve përkatës në lidhje me një kontroll doganor.	Në proces
Nr. 63	MIE	10.06.2019	Subjekti pretendon se duhet të kishte qënë pjesë e degjesës në lidhje me hartimin e një projekti.	Në proces
Nr. 64	Bashkia	10.06.2019	Subjekti kërkon përgjigje në lidhje me planin zhvillimor të zonës.	Në proces
Nr. 65	MFE	11.06.2019	Subjekti kërkon të punësojë disa nga azilantët iranian të vendosur pranë fabrikës tyre, dhe kërkon të dijë nëse kjo është e mundur.	Në proces
Nr. 66	Komisioni i Ligjeve	11.06.2019	Subjekti kërkon disa ndryshime në Kodin Penal për sigurinë ushqimore.	Në proces
Nr. 67	MFE	12.06.2019	Subjekti kërkon anulim të vendimit për detyrime doganore nga Drejtoria Doganore.	Në proces
Nr. 68	MFE	17.06.2019	Subjekti kërkon informacion mbi rimbursimin e TVSH-së.	
Nr. 69	MBZHR	18.06.2019	Subjekti kërkon të shfrytëzojë ujërat e rezervuarit të Belesovës për prodhimin e energjisë elektrike.	Në proces
Nr. 70	MBZHR	18.06.2019	Subjekti kërkon anulim dhe ndryshim të disa masave administrative "dënim me gjobë".	Në proces
Nr. 71	Bashkia	18.06.2019	Subjekti ankohet për taksat vendore.	Në proces
Nr. 72	MBZHR	19.06.2019	Subjekti pretendon se konkurrentet nuk plotësojnë kushtet për prokurimin publik "Blerje automjetesh".	Në proces
Nr. 73	MIE	19.06.2019	Subjekti ankohet lidhur me procedurat e prokurimit.	Në proces
Nr. 74	MIE	19.06.2019	Subjekti kërkon informacion me statusin e çeshtjes gjyqësore në Apel.	Në proces
Nr. 75	Bashkia	19.06.2019	Subjekti kërkon informacion në lidhje me projektin e Bashkisë së Tiranës në lidhje me Ujesjellesin e Gurit të Bardhe.	Në proces
Nr. 76	MSHMS	20.06.2019	Subjekti ankohet për gjobë të vendosur nga ISHSH.	Në proces
Nr. 77	MFE	20.06.2019	Subjekti kërkon shtyrjen e afatit të Magazines së lire, si dhe miratimin e shtimit të kapacitetit/sipërfaqes mbajtës të depozitave të	Në proces

			karburantit në autorizimin e për magazinë të lirë.	
Nr. 78	MFE	21.06.2019	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së brenda afateve të caktuara.	Në proces
Nr. 79	MD	21.06.2019	Subjekti kërkon marrjen e lejes se plazhit përpara pronës që ka blerë në Sarandë.	Në proces
Nr. 80	Ministria e Drejtësisë	24.06.2019	Subjekti kërkon të informojë se ka aplikuar zyrtarisht aplikimin për regjistrimin e pronës pranë sportelinit të Hipotekës.	Në proces
Nr. 81	MFE	24.06.2019	Subjekti kërkon asistencë për mbylljen e aktivitetit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr. 82	MBZHR	25.06.2019	Subjekti kërkon asistencë për monitorimin dhe ndryshimin e temperaturës në liqenin e Vaut të Dejes që ndikon aktivitetin e tyre për trajtimin e Troftës.	Në proces
Nr. 83	MIE	26.06.2019	Subjekti kërkon që MIE të marrë një vendim për zbardhjen e lejes së ndertimit në lidhje me ndertimin e centralit elektrik fotovoltaiq.	Në proces
Nr. 84	MFE	26.06.2019	Subjekti kërkon përgjigje nga Drejtoria Doganave në lidhje me rivlerësimin e pajisjeve nga ana e Doganës.	Në proces
Nr. 85	APP	26.06.2019	Subjekti ankohet në lidhje me procedurat e prokurimeve.	Në proces
Nr. 86	MIE	27.06.2019	Subjekti kërkon asistencë në lidhje me policinë e Vlores për punën e agjensive detare.	Në proces